



РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА
REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT

Бр./Nr _____

_____ г./в.



Në bazë të nenit 22 paragrafi 1 të Ligjit për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 12/19), neni 40 paragrafi 2 i Rregullores së punës së Komisionit Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit, duke vepruar në rastin e formuar pas kërkesës së paraqitur nga parashtruesi i njohur, Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit (në tekstin e mëtejme KSHPK), në seancën e 84-të të mbajtur më 31.02.2023 ka miratuar si në vijim.

VENDIM

Denoncimi I regjistruar me numër 12 - 3725/1 të datës 13.04.2022, me pretendime kundër më shumë personave juridik privat nga -----, HIDHET POSHT.

KSHPK-ja konstatoi se, në përputhje me dispozitat e Ligjit për Parandalimin e Korrupsionit dhe Konfliktit të Interesit, nuk ka elemente për veprim kompetent për faktin se nuk ka pretendime apo indikacione të qarta për veprime të paligjshme apo të palejueshme të zyrtarëve në ushtrimin e kompetencave publike dhe detyrave zyrtare në detyrë, ndërsa KSHPK nuk ka mundësi të japë informacion shtesë për pretendimet në denoncim për faktin se bëhet fjalë për denoncim anonim.

Lënda me numër 12 - 3725/1 të datës 13.04.2022 të mbyllet dhe të arkivohet.

Ky vendim në formë të depersonalizuar do të publikohet në faqen e internetit të KSHPK-së brenda 5 (pesë) ditëve nga miratimi

Arsyetim

Më datë 13.04.2022, një parashtrues i panjohur ka bërë denoncim me nr. 12 - 3725/1, datë 13.04.2022, pas së cilës është ngritur rasti me pretendime kundër disa personave juridikë privatë nga ----- dhe kërkohet që të ngritet procedurë ndaj tyre. Denoncimi anonim i dorëzuar është i shkruar me dorë, i çrregullt dhe me shkrim të palexueshëm, me referenca të kryqëzuara nga të cilat është e vështirë të kuptohet se për çfarë saktësisht bëhet fjalë, si dhe për cilat kompani private i referohet denoncimi dhe për cilën periudhë të funksionimit të tyre.

Gjatë shqyrtimit të denoncimit anonim, KSHPK-ja konstaton se në denoncim nuk ka pretendime apo indikacione të qarta për veprime të paligjshme ose të palejueshme të zyrtarëve në ushtrimin e kompetencave publike dhe detyrave zyrtare, si dhe KSHPK-ja nuk ka mundësi të japë informacion shtesë për pretendimet në denoncim për faktin se është denoncim anonim.

Për këtë arsye, KSHPK-ja vlerësoi se nuk kishte elemente për veprimin e duhur të KSHPK-së për këtë çështje dhe vendosi si në dispozitën e kësaj vendimi.

**KOMISIONI SHETËRORË
PËR PARANDAËIMIN E KORRUPSIONIT
Nënkryetare,
Katica Nikolovska**

Përgatiti: J.C,
miratoi : Mr. Sh.S, Anëtar i KSHPK-së

